



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK**

Nr 1180 Prot.

Gjirokastrë, më 22/09/2020

VENDIM

Nr. 30 datë 22.09.2020


**PËR MIRATIMIN E DATËS SË DHËNJES SË DIPLOMËS PËR PROGRAMET
PROFESIONALE 2-VJEÇARE**

Në mbështetje të: ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 70, pika 4 dhe nenet 72 dhe 91; urdhërave të MASR-së për hapjen e programeve me karakter profesional pranë FE: "Ndihmës Ekonomist", "Asistent Administrativ", "Asistent Menaxher në Shërbimet Turistike", nr. 396, datë 10.07.2018, nr. 393, datë 10.07.2018, nr. 427, datë 18.07.2018, si dhe urdhërave për regjistrimin e formave të diplomave, përkatësish, nr. 15, datë 25.03.2019, nr. 16, datë 25.03.2019, nr. 17, datë 25.03.2019; urdhërave të MASR-së për hapjen e programeve me karakter profesional pranë FESHSH: Edukatorë për zhvillimin e fëmijërisë së hershme 0-3 vjeç", "Udhërrëfyes turistik" dhe "Librar dhe Biblioketar", nr. 453, datë 25.07.2018, nr. 450, datë 25.07.2018, nr. 403, datë 25.07.2019, si dhe urdhërave për regjistrimin e formave të diplomave, përkatësish nr. 12, datë 25.03.2019, nr. 14, datë 25.03.2019, nr. 47, datë 21.02.2020; vendimit të Rektoratit nr. 11, datë 22.09.2020, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, në mbledhjen e tij të datës 22.09.2020,

VENDOSI

1. Të miratojë datën e dhënjes së Diplomave Profesionale ditën e hënë të javës së parë pas mbylljes së sezonit të verës dhe ditën e hënë të javës së parë pas mbylljes së sezonit të vjeshtës në vitin akademik në të cilin mbyllet studimet e tyre.
2. Të miratojë modelin e fletës së dhënjes së diplomës profesionale, e cila i bashkëlidhet vendimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe u përcillet për zbatim administratorit, zëvendës rektorit për procesin mësimor, dekanëve të njësive kryesore, drejtuesve të njësive bazë, kryesekretares mësimore, sektorit të standarteve dhe korrikulave.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK


Prof.dr.Bektash MEMA

